



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI  
KOMBËTAR I TERRITORIT

**MIRATOHET**

KRYETARI K.K. T-SC  
**Z. EDI RAMA**

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU

**NISMA PËR HARTIMIN E**

**PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË  
MBETJEVE TË NGURTA**

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 6, Datë 17.05.2019

*Propozuar nga:*

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**



# **DOKUMENTI I NISMËS**

## **PËR HARTIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA**

***PKS MMN***

*Propozues:*  
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**



## Tabela e Lëndës

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>2. ANALIZA DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT.....</b>	<b>6</b>
2.1. Situata e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në vendin tonë.....	6
2.2. Qëllimi për hartimin e dokumentit dhe Objektivat e tij .....	8
<b>3. KUFIJTË E TERRITORIT QË MBULON DOKUMENTI I PLANIFIKIMIT .....</b>	<b>8</b>
<b>4. LISTA E DOKUMENTEVE PËRBËRËS TË PKS-SË.....</b>	<b>10</b>
4.1. Strukturat dhe formati i PKS.....	10
<b>5. EKSPERTËT QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË HARTOJNË PKS-NË .....</b>	<b>11</b>
<b>6. PROCESI I KËSHILLIMIT DHE BASHKËRENDIMIT .....</b>	<b>13</b>
6.1. Fazat dhe hapat kryesore.....	14
6.2. Strukturat.....	15
<b>7. PLANI I VEPRIIMEVE.....</b>	<b>16</b>
7.1. Parimet gjithëpërfshirëse.....	16
7.2. Përbledhje e strategjive .....	16
7.3. Baza ligjore e Planit Kombëtar Sektorial.....	17
7.4. Përbledhje e Planeve Kombëtare, Rajonale e Vendore.....	19
7.5. Integrimi dhe përputhshmëria .....	20
7.6. Baza e të dhënave.....	20
<b>8. BUXHETI .....</b>	<b>22</b>
<b>9. PËRFUNDIMI I DOKUMENTIT TË NISMËS .....</b>	<b>22</b>



## 1. HYRJE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoritet me përgjegjësi në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane në lidhje me planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, ka ndërmarrë nismën për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta.

Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, përcakton se: “*Planet kombëtare sektoriale hartohen nga ministritë, me qëllim zhvillimin strategjik të një ose më shumë sektorëve të ndryshëm, sipas fushave të kompetencës si siguria kombëtare, energjia, industria, transporti, infrastruktura, turizmi, zonat ekonomike, arsimi, sporti, trashëgimia kulturore dhe natyrore, shëndetësia dhe ujërat*”.

Në vijim, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, përcakton se: “*Çdo subjekt i interesuar mund t'i kërkojë Autoritetit përgjegjës të planifikimit marrjen e nismës për hartimin e dokumenteve të planifikimit, nëpërmjet një kërkesë drejtuar autoritetit përgjegjës, sipas përcaktimeve të Ligjit dhe kësaj rregulloreje. Gjithashtu, vetë Autoriteti përgjegjës i planifikimit, mbart detyrimin ligjor të ndërmarrë nisma planifikimi në zbatim të planeve që qëndrojnë më lart në hierarki, sipas përcaktimeve të Ligjit, apo kur e çmon të nevojshme rishikimin e dokumenteve ekzistuese të planifikimit*”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, kërkesën për ndërmarrjen e nismës për Planin Kombëtar Sektorial mund ta bëjë çdo subjekt i interesuar. Në këtë rast, ndërmarrja e nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (PKS MMN), bëhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Ligji i planifikimit dhe zhvillimit të territorit përcakton se, autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit në nivel qendror janë: *Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Territorit, Ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit*.

**Sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit, procesit të punës për hartimin e PKS-në i paraprin ndërmarrja e nismës për hartimin e tij.**

*Autoriteti përgjegjës për ndërmarrjen dhe hartimin e nismës është ministri që mbulon sektorin, i cili e paraqet atë pranë Këshillit Kombëtar të Territorit për miratim. Në rast se plani hartohej për të analizuar në formë të integruar disa sektorë, atëherë nisma ndërmerrret nga disa ministra së bashku.*

Bazuar sa më sipër, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, është autoriteti përgjegjës për ndërmarrjen e nismës dhe hartimin e PKS MMN, si ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në nivel qendror, si dhe si autoritet përgjegjës, i cili mbulon sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta.



Me kërkesë të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit miraton dokumentin e Nismës, si dhe dokumentit të plotë të Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta. Më poshtë paraqitet në mënyrë skematike i gjithë procesi që do të ndjekë



hartimi i nismës dhe miratimi i Planit Kombëtar Sektorial i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në KKT.

Dokumenti i Nismës, përban:

- a) analizën, e cila përcakton qëllimin dhe nevojën për hartim ose rishqyrtim të dokumentit të planifikimit;
- b) kufijtë e territorit që mbulon dokumenti i planifikimit;
- c) listën e dokumenteve përbërëse të PKS-së;
- d) ekspertët (fushat e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojnë PKS-në;
- e) përcaktimet për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike dhe afatet përkatëse;
- f) planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të PKS-së;
- g) buxhetin për hartimin e PKS-së;

*Duhet patur parasysh që:*

Gjatë hartimit të planit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së bashku me AKPT duhet të sigurojë një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, në fillim të procesit dhe gjatë hartimit të tij. Ministria këshillohet me AKPT-në e palët e interesuara, të cilat i vë në dijeni periodikisht për securinë e procesit të hartimit. AKPT-ja ndihmon dhe propozon përmirësimet e nevojshme të planit të veprimeve dhe të projektit të dokumentit kombëtar të planifikimit.

Në bazë të Ligjit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Rregullores së Planifikimit, procesi i bashkërendimit dhe këshillimit dhe i gjithë procesi që do të ndjekë hartimi dhe miratimi i PKS-së MMN, sipas situatave specifike dhe kompleksitetit të tij, zhvillohen sipas fazave të mëposhtme:

## Faza I

Merret vendimi nga Ministri përgjegjës për çështjet e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për ndërmarrjen e nismës. Vendimi i Ministrit përgjegjës për marrjen e nismës, botohet në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT), brenda 10 ditëve nga data e marrjes së nismës.

Me Urdhër të Ministrit ngritet grupei i punës, i cili do të jetë përgjegjës për hartimin e dokumentit



të PKS-së. Pjesë e grupit të punës janë dhe përfaqësues nga AKPT. Vendimi i Ministrit për marrjen e nismës publikohet edhe në faqen zyrtare të ministrisë.

## Faza II

Me marrjen e nismës për hartimin e dokumentit, Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit (Ministri përgjegjës për çështjet e menaxhimit të mbetjeve) organizon, të paktën një takim këshillues dhe një takim informues për publikun.

Ministri njofton vendin, datën dhe orën e takimit këshillimor dhe atij publik, të paktën 30 ditë para seçilit takim, si edhe vë në dispozicion dokumentin e nismës apo atë të planifikimit, të paktën 20 ditë para takimit. Njoftimi kryhet përmes botimit në RKPT dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit publik.

## Faza III

Ministri përgjegjës për çështjet e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta dërgon për miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit, Dokumentin e Nismës për hartimin e Dokumentit të PKS-MMN.

## Faza IV

KKT merr vendim për miratimin e dokumentit të Nismës për hartimin e PKS-MMN. Vendimi i KKT-së për miratimin e Nismës, së bashku me dokumentin e nismës botaohen në RKPT brenda 10 ditëve nga data e miratimit.

Vendimi i KKT-së dhe Dokamenti i Nismës bëhen publike edhe në faqen zyrtare të Sekretariatit të KKT-së dhe autoritetit përgjegjës të planifikimit.

Dokamenti i Nismës hyn në fuqi me botimin e vendimit të KKT-së dhe dokumentit të plotë të Nismës në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

## Faza V

Pas ndërmarrjes së Nismës për hartimin e PKS-MMN, me Urdhër të Drejtore të AKPT-së, konstituohet Forumi për Bashkërendimin e Planifikimit në Nivel Qendror (FBPQ). Në Urdhrin e konstituimit përcaktohen detyrat, përgjegjësitë dhe programi i punës së FBPQ.

## Faza VI

Ministri që mbulon sektorin, me Urdhër, ngre grupin e punës që do të zbatojë planin e veprimeve për hartimin e PKS-së. AKPT është në çdo rast pjesë e grupit të punës.

Hartuesit e dokumentit të planifikimit nënshkruajnë një Deklaratë Notoriale të Përgjegjësisë Profesionale, ku dëshmojnë se dokumenti i dorëzuar pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit është në përputhje me legjisacionin në fuqi në fushën e planifikimit e të zhvillimit, si edhe me legjisacionet e tjera që ndikojnë planifikimin e territorit.

## Faza VII

Procesi i miratimit të PKS-së përban të paktën këto hapa:

- Kërkesën e autoritetit përgjegjës për shqyrtim dhe miratim të PKS-së në KKT;
- Rishikimin/ përmirësimin e dokumentit të PKS-së nga autoriteti përgjegjës;
- Vendimmarrjen e KKT-së.



## **Faza VIII**

Pas botimit në RKPT të dokumentit të plotë të PKS-së, autoriteti përgjegjës bën kërkesën për marrjen e Aktit të Përputhshmërisë nga Agjencia.

AKPT shqyrton përputhshmërinë e dokumentacionit të PKS-së brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes për shqyrtim përputhshmërie të dokumentacionit të plotë.

Në përfundim të periudhës 30 ditore të shqyrtimit të përputhshmërisë, AKPT harton dhe boton në RKPT Raportin e Vlerësimit Teknik të PKS-së dhe Aktin e Përputhshmërisë, sipas rastit.

Materialet që dorëzohen/ botohen për miratimin e dokumentit të planifikimit janë:

- a) Dokumenti i Nismës e miratuar në KKT;
- b) Dokumenti i PKS-së i plotë;
- c) Akti i miratimit nga autoriteti përgjegjës për Studimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, referuar legjislativit të posaçëm në fuqi;
- d) Akti i përputhshmërisë nga AKPT, ose Deklarata e përputhshmërisë në heshtje.

## **Faza IX**

Pas botimit në Regjistër të dokumentit të plotë të PKS-së, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë bën kërkesën për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit të planifikimit në KKT. KKT merr vendim në lidhje me miratimin e PKS-MMN.

Vendimi i miratimit të dokumentit të PKS-së botohet në RKPT brenda 15 ditëve nga data e miratimit.

## **Faza X**

Dokumenti i Planit Kombëtar Sektorial (PKS) hyn në fuqi me botimin e plotë në RKPT të vendimit të KKT-së dhe dokumenteve shoqëruar të tij.

## **2. ANALIZA DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT**

### **2.1. Situata e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në vedin tonë**

Sektori shqiptar i menaxhimit të mbetjeve karakterizohet nga një sasi në rritje e mbetjeve nga njëra anë dhe nga kapacitetet e papërshtatshme institucionale, financiare, administrative dhe teknike nga ana tjeter.

Në vitin 2016, mbi bazën e të dhënave që publikohen nga INSTAT dhe krahasimisht me ato që mblidhen e përpunohen nga MIE, raportohet se shërbimi i grumbullimit të mbetjeve i jepet rrëth 68.7 % të popullsisë.

Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga INSTAT, në 2016 në Shqipëri janë prodhuar rrëth 2.2 milionë ton nga të cilat 1,072,236, mbetjet të ngurta bashkiakë, përmbi të cilën llogariten rrëth 17% ose 221,000 ton/vit mbetje jo-urbane (industriale ose ndoshta inerte). Sipas këtyre të dhënave në 2016, është prodhuar rrëth 373 kg/banor vit mbetje të ngurta bashkiakë.



Duke u nisur nga niveli i mbulimit me shërbim rezulton se në vend grumbullohen rreth 736,626 ton mbetje të ngurta bashkiake, ndërsa pjesa tjetër depozitohet në mënyrë të pakontrolluar, duke konfirmuar dy nga problemet madhore me të cilat përballet vendi:

1. Grumbullimi i kufizuar i mbetjeve në të gjithë territorin e aksesueshëm të vendit, dhe
2. Sigurimi i një vendi të sigurtë dhe të kontrolluar për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të grumbulluara.

Procedurat ligjore ngarkojnë bashkitë me përgjegjësi për depozitimin, trajtimin dhe menaxhimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve. Depozitimi dhe trajtimi final i mbetjeve të ngurta bashkiake është përcaktuar si një problem po aq i rëndësishëm sa dhe grumbullimi i tyre.

Në Shqipëri janë në punë vetëm 3 (tre) venddepozitime sanitare (landfill-e), respektivisht në Bajkaj (Sarandë), Bushat (Shkodër), dhe Sharrë (Tiranë). Gjithashtu gjenden edhe disa objekte të tjera, të cilat mund të konsiderohen si venddepozitime të kontrolluara, ndërsa mbi 89 vend depozitime nuk plotësojnë standartet minimale sanitare.

Të tre landfill-et, përfshi këtu edhe atë të Maliqit (të sapo ndërtuar), si dhe atë të Vlorës (në projekt) administrohen nga njësitet vendore duke përdorur forma të ndryshme menaxhimi.

MZHU (Ministria e Zhvillimit Urban) në vitin 2013, pa nevojën për vlerësimin e situatës në lidhje me vend-depozitimet e mbeturinave urbane në vend. Sektori i Mbetjeve të Ngurta, në Drejtoren e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit në MZHU, bëri të mundur mbledhjen e informatave me anë të shkresave zyrtare dhe vizitave në terren lidhur me demografinë, projekte të ndryshme, planeve të ndryshme, distancave nga zona interesit, lejeve mjedisore, rrëthimeve, aktivitatave të rehabilitimit dhe trajtimit, llojeve të mbetjeve të depozituara ndër vite, sasitë ditore të mbetjeve, etj.

Pas vizitave në terren të dhënat e grumbulluara u integruan në një hartë / bazë të dhëna WebGIS: <http://mbetjet.zhvillimiurban.gov.al/GISDefault.aspx?idTheme=28297>

në të cilin paraqiten vend depozitimet e mbetjeve, të cilat ligjërisht duhet të administrohen nga bashkitë që depozitojnë mbetjet në to. Gjithsesi, numri i vendeve ku mbetjet hidhen në mënyrë të pakontrolluar është shumë më i madh se sa paraqiten në këtë sistem.

Përveç mbetjeve që depozitohen në landfill-e, trajtimi për pjesën më të madhe të mbetjeve bëhet me metoda të thjeshta. Në rastin më të mirë mbizotëron thjesht ngjeshja dhe mbulimi. Në përgjithësi, lëngjet dhe gazet që vijnë nga dekompozimi nuk kapen dhe nuk trajtohen, duke u bërë një problem akut për mjedisin në Shqipëri.

Në këto kushte lind nevoja për vijimin më tej të punës së nisur nga MZHU, për të identifikuar të gjitha vendet e depozitimit si dhe gjendjen e tyre. Mbyllja sanitare e tyre do të ketë një kosto të konsiderueshme shtesë për menaxhimin e mbetjeve në mënyrë mjedisore.

Në mënyrë alternative, ka filluar trajtimi përfundimtar i mbetjeve nëpërmjet incinerimit me rikuperim energjie. Në vitin 2017, në Elbasan është ndërtuar dhe ka filluar të funksionoje incineratori i parë me rikuperim energjie në Shqipëri. Janë projektuar dhe 2 (dy) incineratorë të tjera, respektivisht në Fier dhe Tiranë.



## 2.2. Qëllimi për hartimin e dokumentit dhe Objektivat e tij

Qëllimi i përgjithshëm i Studimit Sektorial është të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit, shfrytëzimin me përgjegjësi të burimeve natyrore dhe shëndetit të njeriut, si dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Më konkretisht studimi i sektorit ka për qëllim eliminimin e investimeve spontane, të cilat nuk janë të bazuara në studime, ose të miratuara nga politikëbërësit me pasoja serioze në:

1. Bërjen e fondeve publike joefikase dhe,
2. Krijimin e pikave të nxeha që kërkojnë më shumë fonde dhe burime për t'u kthyer në kushte normale të pranueshme.

Objektivat e studimit janë të lidhura me objektivat e sektorit kombëtar, përkatësisht ofrimin e shërbimeve të Menxhimit të Mbetjeve të Ngurta për të gjithë vendin, reduktimin dhe riciklimin e fraksioneve përkatëse të mbeturinave, zvogëlimin e numrit të vendeve të pakontrolluara dhe të hedhjes së mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit. Objektivat dytësore janë zbatimi i parimit "konsumatori dhe ndotësi paguan" si dhe përgatitja e procesit të pranimit në BE (sidomos në përbushjen e standardeve mjedisore).

Një objektiv tjetër i këtij studimi është përcaktimi i një Plani Kombëtar të Investimeve në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.


Objektivat specifike të Studimit Sektorial janë:

1. Të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në këtë sektor;
2. Të përcaktojë kostot dhe tarifat e duhura;
3. Të sigurojë një sistem objektiv, të verifikueshëm dhe transparent të prioriteteve të investimeve të infrastrukturës së MMN që ndërtohet në vlerësimin e nevojave dhe ndikimeve;
4. Të sigurojë një plan investimi në fazë për infrastrukturën e MMN lokale dhe rajonale për periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, në lidhje me grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, reduktimin dhe riciklimin e mbeturinave dhe objektet e trajtimit dhe/ose deponimit.
5. Të propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale që do të bëjnë planin e investimeve tregues të situatës aktuale, në përpunhje me prioritetet dhe politikat kombëtare dhe të zbatohet me lehtësi.
6. Të propozojë ndonjë masë tjetër shoqëruese që do ta bëjë studimin e sektorit më të zbatueshëm dhe më të zbatueshëm.

## 3. KUFIJTË E TERRITORIT QË MBULON DOKUMENTI I PLANIFIKIMIT

Dokumenti i planifikimit do të mbulojë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.





Harta Administrativo-Territoriale e Shqipërisë



## 4. LISTA E DOKUMENTEVE PËRBËRËS TË PKS-SË

Sipas kuadrit ligjor në fuqi përcaktohet se planifikimi i territorit mbështetet në politikat e miratuara dhe vihet në zbatim në një territor të caktuar gjatë një periudhe të përcaktuar kohore. Gjithashtu, sipas Regullores së Planifikimit të Territorit, "Plani Sektorial Kombëtar (PKS), teksa hartoheret e zbatohet duhet të ndjekë parimet e planifikimit si një proces pune përherë në vazhdimësi".

Bazuar në përcaktimet e Rregullores së Planifikimit të Territorit, elementet përbërëse të dokumentit të Planit Kombëtar Sektorial janë:

1. Dokumenti i Analizës dhe vlerësimit për sektorin:
  - 1.1. *Analiza e dokumentave pararendëse të sektorit dhe legjislativit;*
  - 1.2. *Analiza e përgjithshme e sektorit;*
  - 1.3. *Analiza socio-ekonomike me rëndësi për sektorin.*
2. Strategjia sektoriale dhe planin e zhvillimit të sektorit:
  - 2.1. *Strategjia e sektorit;*
  - 2.2. *Planin e propozimeve sektoriale;*
  - 2.3. *Planin e llojit të infrastrukturave në varësi të sektorit;*
  - 2.4. *Planin e veprimeve për zbatimin e PKS në fazë.*
3. Hartat shoqëruese për pikat e mësipërme;
4. Studimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor;
5. Informacionin e plotë gjeohapësinor për sektorin e integruar në platformën GIS, sipas standardeve të Regjistrat Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

### 4.1. Strukturat dhe formati i PKS-së

**Raporti:** Raporti mbi PKS për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta do të përmbytë si vijon:

- ✓ Hyrje;
- ✓ Qëllimi dhe objektivat e hartimit të PKS për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta;
- ✓ Analiza e dokumentave pararendëse të sektorit dhe legjislativit;
- ✓ Analiza sektoriale e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta: Prezantohet situata aktuale dhe e parashikuar, duke konsideruar prirjet ekzistuese për zhvillim dhe mundësitë e zgjidhjes së problemeve apo çështjeve, ku përfshihet menaxhimi i mbetjeve në një kuadër të ndërthurur me sektorë të tjera. Në të njëjtën kohë, ajo duhet të identifikojë se si pasqyrohen politikat kombëtare në prirjet dhe planet aktuale si dhe të prektet analiza socio-ekonomike me rëndësi për sektorin;
- ✓ Konkluzione të analizës dhe çështjet kryesore: Do të duhet të përfshihet situata aktuale e çështjeve dhe problemeve kryesore, të lidhura me: shërbimet në përgjithësi dhe atyre në fushën e menaxhimit të mbetjeve në vecanti, etj;
- ✓ Strategjia: Vizioni i parashikuar në PKS për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta duhet të shprehë objektivat e gjithëpranuara të zhvillimit të territorit kombëtar, bashkangjitur me prezantimin e politikave rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, të cilat janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e sektorit shoqëror, ekonomik dhe mjedisor;



- ✓ Skenarët strategjikë për zhvillimet potenciale të 10-15 viteve në vijim dhe arsyetimin për secilin prej tyre, përfshirë tregimin paraprak të llojeve të zhvillimeve plotësuese që kërkohen për të arritur modelet e propozuara;
- ✓ Orientimet për zhvillimet sektoriale, që tregojnë se si ato kontribuojnë për përbushjen të "Vizonit" për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta. Këtu duhet të identifikohen vendndodhjet ku pritet të ndodhin këto zhvillime. Njëkohësisht, duhen identifikuar kriteret specifike të tokës, karakteristikat gjeomorfologjike etj, në secilën prej fushave kyçe të zhvillimit, nevoja për përmirësimin e infrastrukturës kryesore dhe çështje të tjera të rëndësishme, sidomos ato që përbëjnë kërcënëm për mjesidin apo kërkijnë një trajtim me ndjeshmëri të posaçme. Në këtë kontekst, duhen paraqitur edhe hartat treguese për vendndodhjet e propozuara për zhvillim;
- ✓ Vizioni hapësinor i PKS: Harta e përbërë e propozimeve në PKS formon diagramin kryesor, i cili paraqet në mënyrë diagramatike të gjitha propozimet. Plani i Fazave të Ndërhyrjeve dhe Plani Strategjik i Financimit: këto duhet të identifikojnë shkallën e përafërt të investimeve të kërkuaara për sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta dhe njëkohësisht për çdo sektor ndikues si dhe burimin e pritshëm të investimit (publik ose privat dhe, në rastin e investimit publik, nëse do të jetë kombëtar, rajonal apo lokal). Këtu mund të përfshihen edhe harta që tregojnë fazat e zhvillimit;
- ✓ Procesin e analizimit të gjithë territorit të zonës së Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta që përfshihet në projekt: Hulumtime në terren dhe kërkime në institucionet përkatëse që merren me studimet dhe politikat e planifikimit të territorit, programet dhe dinamikat e zhvillimit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, etj;
- ✓ Shqetësimet dhe çështjet kryesore: Do të duhet të përfshihet situata aktuale e çështjeve dhe problemeve kryesore për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, në lidhje me përkujdesjen dhe përmirësimin e këtij shërbimi;
- ✓ Korniza Institucionale për Zbatimin.

**Hartat:** PKS do të mbështetet nga Hartat Analitike, të cilat tregojnë situatën aktuale, prirjet dhe sfidat e planifikimit që ndikojnë në sektorin e Menaxhimit e Mbetjeve të Ngurta, propozimet, planin e veprimit sipas fazave, llojet e infrastrukturave, impaktet e mundshme, etj.

## 5. EKSPERTËT QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË HARTOJNË PKS-NË

Plani i veprimeve për hartimin e PKS-së zbatohet nga grupei i punës i ngritur me Urdhër të Ministrit që mbulon sektorin (MIE). Plani Kombëtar Sektorial (PKS) hartohet nga grupe pune me specialistë të institucioneve publike, me ekspertë të fushave të ndryshme të huaj e vendas, sipas përcaktiveve të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave.

AKPT do të jetë në çdo rast pjesë e grupit të punës.

Bazuar në nenin 14, pika 3 të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar,

Formimi akademik i profesionistëve për secilën nga fushat përcaktohet si më poshtë:



- a) për planifikimin e territorit: planifikim dhe menaxhim urban, hapësinor dhe territori, urbanistikë ose projektim urban dhe fusha të tjera ekuivalente studimi, sipas legjislacionit të arsimit;
- b) për kontrollin e zhvillimit: fushat sipas shkronjës "a", të kësaj pike, juridik, arkitekturë, inxhinieritë e ndërtimit, topogjeodezi;
- c) për mbrojtjen e mjedisit: menaxhim mjedisi urban, inxhinieritë e mjedisit dhe të agromjedisit, studime mjedisore, arkitekturë dhe projektim peizazhi, gjeologji, inxhinieri pyjesh, etj;
- d) për administrimin e regjistrat: "GIS" dhe topogjeodezi ose, në mungesë, planifikim urban, territori, urbanistikë, projektim urban, inxhinieritë e ndërtimit ose arkitekturë me përgatitje dhe eksperiencë në GIS ose topogjeodezi.

Për këtë, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ka firmosur Urdhërin Nr. 926, datë 28.12.2018, "Për ndërmarrjen e nismës dhe ngritjen e urdhrit të punës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta".

Grupi i punës, i cili është përgjegjës për ndjekjen e procedurave, koordinimin e punës dhe hartimin e dokumentit të PKS, perbëhet si më poshtë:

■ Hantin Bonati	Kryetar	Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
■ Lindita Sotiri	Anëtar	Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
■ Anila Morina	Anëtar	Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
■ Marini Veizi	Anëtar	Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
■ Isa Memia	Anëtar	Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
■ Ledjana Karalliu	Anëtar	Përfaqësues i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
■ Sonila Pashaj	Anëtar	Përfaqësues i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
■ Bledi Dimo	Anëtar	Përfaqësues i AKPT-së;
■ Erjona Vurmo	Anëtar	Përfaqësues i AKPT-së;
■ Rezarta Laçi	Anëtar	Përfaqësues i AKPT-së

Për hartimin dhe përgatitjen e studimit, mbështetur në VKM Nr. 645, datë 14.09.2016 "Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, si marrës, dhe KFW Frankfurt am Main, për financimin e shërbimeve të ekspertit ndaj marrësit, në kuadër të një studimi për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta në Shqipëri, financuar nga një fond i veçantë (nr.11469), dhënë nga Qeveria Gjermane", dhe VKM Nr. 46, datë 25.01.2017 "Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, si marrës, dhe KFW



Frankfurt am Main, për financimin e shërbimeve të ekspertit ndaj marrësit, në kuadër të një studimi për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta në Shqipëri, financuar nga një fond i veçantë (nr.11469), dhënë nga Qeveria Gjermane”, është firmosur një kontratë me datë 06.03.2017 ndërmjet Ministrisë së Financave (përfaqësuar nga KFW) dhe Infrastruktur & Umwelt.

Kontrata u fitua dhe po zbatohet nga kompanitë:

- Infrastruktur & Umwelt;
- Cowi;
- Flag.

Ekspertët e kontraktuar për të kryer këtë shërbim janë:

1. Gernod Dilewski;
2. Alba Dakoli-Wilson;
3. Klaus Grimm;
4. Orhan Boran;
5. Alexandra Selz ;
6. Kezia Emanuel;
7. Alfred Lako;
8. Megi Rusi.

## 6. PROCESI I KËSHILLIMIT DHE BASHKËRENDIMIT

Menjëherë pas ndërmarrjes së nismës, vendimi i Ministrit përgjegjës për marrjen e kësaj nisme do të botohet në RKPT, brenda 10 ditëve nga data e marjes së nismës.

Pas miratimit të Nismës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të organizojë, të paktën një takim këshillues dhe një takim informues për publikun. Për këto takime do të njoftohen palët e interesuara të paktën 30 ditë para secilit takim. Autoritetet më kryesore të planifikimit që do duhet të jenë pjesëmarrëse në këto takime janë:

Autoritetet që do të jenë pjesë e takimeve:

- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Instituti i Shëndetit Publik;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Kulturës - institucionet në varësi;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Përfaqësues të Njësive Administrative Vendore;
- Agjencitë e Zhvillimit Rajonal;
- Përfaqësues të Qarqeve që preken nga PKS;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.



## 6.1. Fazat dhe hapat kryesore

Menjëherë pas miratimit të nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (PKS) nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), do të bëhet njoftimi i palëve të interesuara dhe dokumenti i kërkesës për nismën së bashku me aktin e miratimit do të botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

Ligji “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” përcakton se gjatë procesit të hartimit të dokumentit të PKS autoriteti përgjegjës (Ministria) është përgjegjëse për të bashkëpunuar me autoritetet e planifikimit të çdo nivelit, dhe të raportojë rregullisht sipas hierarkisë. Gjithashtu Ministria ka detyrimin për të informuar publikun për të gjithë procesin planifikues dhe për të siguruar transparencë nëpërmjet regjistrimit dhe formave e burimeve të tjera tradicionale.

Në varësi të këtij përcaktimi hapat më kryesore janë si më poshtë:

- Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit sektorial të planifikimit do të sigurojë një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, në fillim të procesit si dhe gjatë hartimit të dokumentit të planifikimit sektorial të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta.
- Përbledhje e vërejtjeve dhe sugjerimeve gjatë takimit publik, batohet në RKPT të nesërmen e datës së takimit publik.
- Ky autoritet këshillohet me AKPT-në e palët e interesuara, të cilat i vë në dijeni periodikisht për ecurinë e procesit të hartimit.
- AKPT-ja ndihmon dhe propozon përmirësimet e nevojshme të planit të veprimeve dhe të projektit të dokumentit sektorial të planifikimit për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.
- AKPT-ja siguron që hartimi i dokumenteve të planifikimit të territorit, në nivel qendror dhe vendor, është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, përmes ofrimit të ndihmës teknike për autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit.
- Me Urdhër të Drejtorit të AKPT-së, konstituohet Forumi për Bashkërendimin e Planifikimit në Nivel Qendror (FBPQ). Në Urdhrin e konstituimit përcaktohen detyrat, përgjegjësitë dhe programi i punës së FBPQ. FBPQ përbëhet nga përfaqësues të ministritve, të cilat trajtojnë çështje që ndikojnë direkt në planifikimin e territorit, si: turizmi, mjediseti, bujqësia, burimet natyrore, transporti, infrastruktura, etj.
- MIE, si autoritet përgjegjës për hartimin e PKS MMN organizon një ose më shumë takime publike përpëra çdo vendimmarjeje planifikuese dhe i përsërit ato sipas nevojës për informimin e plotë të palëve të interesuara dhe zgjidhjen e konflikteve.
- Organizimi i takimeve publike kryhet si më poshtë vijon:



- Autoriteti përgjegjës i planifikimit njofton vendin, datën dhe orën e takimit këshillimor dhe atij publik, të paktën 30 (tridhjetë) ditë para seçilit takim, si dhe vë në dispozicion dokumentin e nismës apo atë të planifikimit, subjekt këshillimi. Njoftimi kryhet përmes botimit në RKPT dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit publik.
- Raporti me përbledhjet e vërejtjeve dhe/apo propozimeve të shprehura gjatë takimeve këshilluese dhe atyre informuese me publikun botahe në RKPT brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbajtjes së takimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit.
- Autoriteti përgjegjës i planifikimit reflekton në dokumentet e planifikimit vërejtjet dhe/apo propozimet e publikut ose jep arsyet e argumentuara të moskryerjes së një ndryshimi të tillë.

## 6.2. Strukturat

Përsa i përket organizimit të strukturave të përfshira në procesin e hartimit të PKS MMN, ky dokument sektorial planifikimi për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta hartohej nën drejtimin e përgjegjësinë e grupit të punës me ekspertë vendas dhe të huaj, sipas Urdhrit të Ministrit të MIE dhe kontratës së lidhur.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Enerjisë - Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të PKS-MMN. MIE siguron një proces dialogu, bashkëpunimi horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e pale të interesuar, në fillim të procesit dhe gjatë hartimit të dokumentit kombëtar të planifikimit. Ky autoritet këshillohet me AKPT-në e palët e interesuara, të cilat i vë në dijeni periodikisht për ecurinë e procesit të hartimit. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) është autoriteti përgjegjës për të bashkërenduar, në përgjithësi, proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit, të cilat ndërmerren nga autoritetet e planifikimit në nivel qëndror e vendor. Në këtë kuadër AKPT:
  - Ndihamon dhe propozon pëmiresimet e nevojshme të planit të veprimeve dhe të projekteve të dokumentit kombëtar të planifikimit;
  - Organizon takime të FBPQ-së, si dhe është pjesëmarrëse aktive në takimet publike të organizuara nga Ministria.
  - Ofron asistencën e saj, si dhe të dhëna elektronike bazë në ndihmë të hartimit të dokumentit të planifikimit;
  - Kryen kontrollin e përputhshmërisë së dokumentit të planifikimit dhe lëshon Aktin e Përputhshmërisë;
- Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) – Autoriteti përgjegjës për miratimin e dokumentit të planifikimit.



## 7. PLAN I VEPRIJEVE

## 7.1. Parimet gjithëpërfshirëse

Metodologjia e hartimit të PKS për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta do të bazohet në eksperiencën ndërkombëtare dhe kombëtare. Qasja e këtij plani është një qasje territoriale që garanton:

- Mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e përgjegjshëm te burimeve natyrore dhe shëndetit të njeriut, si dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë;
  - Përputhshmërinë me sistemin ligjor dhe atë qeverisës në Shqipëri;
  - Respekimin e kompetencave institucionale të autoriteteve të çdo niveli dhe të nevojave të çdo grupei interesit, në kuadër të konceptit të qeverisjes me shumë nivele;
  - Harmonizimin e prioriteteve dhe politikave kombëtare sektoriale, ndërsektoriale dhe vendore me detyrimet që vijnë nga procesi i përafrimit ligjor me direktivat e BE dhe nga fazat e integrimit;
  - Metodologjikisht, nevojitet që analiza të fokusohet në identifikimin e elementeve të favorshme dhe të pafavorshme në territor dhe të ndikimeve të mundshme në territor dhe në politikën tonë të planifikimit dhe direktivat e BE;
  - Pavarësisht metodologjisë e cila ndërtohet mbi eksperiençat më të mira kombëtare dhe ndërkombe, Plani do të respektojë terminologjinë, kushtet, standartet e planifikimit, kriteret e zhvillimit që përcaktohen në legislacionin shqiptar.

## 7.2. Përbledhje e strategjive

Politika e përgjithshme e planifikimit të territorit, në rastin konkret ajo për *Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (PKS)*, hartohej në përputhje dhe në zbatim të qëllimeve, objektivave dhe rezultateve të prishme, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, si dhe të programeve dhe dokumenteve strategjike të procesit të integrimit europian. Politika mbart e reflekton parimet edhe politikat e Bashkimit European për zhvillim hapësinor dhe “kohezion” territorial. Ajo përfshin gjithashtu objektivat e qëllimet e përcaktuara në strategjitetë sektoriale dhe ndërsektoriale, që ekzistojnë në momentin e hartimit të saj.

Një përbledhje paraprake e dokumenteve strategjike që do të përdoren si bazë dhe reference në procesin e hartimit të PKS-së, është listuar në tabelën e mëposhtme. Por duhet sqaruar se ky listim nuk është shterues dhe për më tepër që gjatë hartimit të këtij plani do të merren në konsideratë edhe të gjitha strategjitë që janë në proces hartimi/draftimi dhe ende nuk janë miratuar nga organet kompetente, kjo për shkak se shumica e strategjive sidomos e atyre vendore janë në proces hartimi ose miratimi dhe akoma nuk janë miratuar përfundimisht.

## Tabela e Strategjive dhe Planeve



Nr.	Akti Miratues	Titulli i Strategjisë	Qëllimi i strategjisë
1	VKM Nr.175, datë 19.1.2011	Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve	Zhvillimin e qëndrueshmë të vendit duke mbrojtur sa më shumë të jetë e mundur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi dhe duke promovuar vlerat mjedisore
2	VKM Nr.774, datë 14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale shqiptare e zhvillimit rural	Shërben si një bazë kombëtare, për zhvillim dhe më pas zbatimin e planeve për zhvillimin rural të rajoneve dhe nënrajoneve të Shqipërisë për të stimuluar qëndrimin dhe rikthimin e banorëve në zonat rurale
3	VKM Nr.847, datë 29.11.2007	Strategjia ndërsektoriale e mjedisit	Trajtim modern dhe i integruar i sektorit mjedisor dhe sektorëve të tjera me ndikim të fortë në cilësinë e mjedisit si transporti, bujqësia, rregullimi i territorit etj
4	VKM Nr. 348, datë 11.05.2016	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020	Dokument i vetëm strategjik (axhenda) për zhvillim ekonomik e social të qëndrueshmë, të harmonizuar me axhendën e integrimit në BE dhe në strukturat e NATOs, si dhe me atë të realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.
5	VKM Nr.643, datë 14.09.2011	Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017	Hartimin e politikave të përshtatshme dhe angazhimin e fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënen e shërbimeve të ujësjellëskanalizime, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standarde të BE
6	VKM Nr.773, date 14.11.2007	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal	Të sigurojë që të gjitha qarqet të janë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin dhe konkurencën e qëndrueshme dhe në këtë mënyrë të reduktojnë pabarazitë sociale dhe ekonomike në të gjithë vendin
7		Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015 - 2020	Paraqet vizionin e qeverisë për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore nëpërmjet përparimit të procesit të decentralizimit sipas standardeve evropiane.

### 7.3. Baza ligjore e Planit Kombëtar Sektorial



Baza kryesore ligjore për Planin Kombëtar Sektorial (PKS) është Ligji nr. Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM Nr. 686, date 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”.

Përgatitja e PKS-së jo vetëm do të përbushë një detyrim të rëndësishëm ligjor, por, në të njëjtën kohë, do të vendosë në zbatim parimet dhe orientimet e Planit e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit (PPKT): *“Infrastruktura të tjera ekonomike dhe sociale si ujësjellës-kanalizime, trajtimi i ujërave të përdorura, transporti, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve, shkollat, spitalet, janë të domosdoshme të vendosen në përputhje me përqendrimin e popullsisë dhe në plotësim të kërkuesave për arritshmëri të përshtatshme nëse synojmë zhvillim të balancuar hapësinor të vendit.”*

Hartimi i planit në fjalë do të sigurojë që objektivat e shpallura në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) të pasqyrohen dhe të përkthehen në vendime, objektiva e programe për zhvillimin e territorit në përgjithësi dhe sektorit të menaxhimit të mbetjeve në vecanti. Gjatë përpilimit, PKS duhet të marrë në konsideratë qoftë SKZHI-në, ashtu edhe të gjitha strategjitet e tjera sektoriale, ndërsektoriale dhe vendore që janë të miratuarë në momentin e hartimit të këtij Plani. Gjithashtu, PKS do të marrë në konsideratë drejtimet dhe politikat sektoriale, direktivat dhe kriteret e BE-së, që orientojnë dhe ndikojnë në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Për ta bërë më të prekshëm këtë proces, më poshtë kemi renditur aktet ligjore që përbëjnë kuadrin ligjor në fuqi në fushën e planifikimit të territorit dhe sektorit të menaxhimit të mbetjeve që do të zbatohet gjatë procesit të hartimit të PKS – së, përfshin aktet e mëposhtme:

- ✓ Ligji Nr. Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
- ✓ VKM Nr. 686, date 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”;
- ✓ VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar;
- ✓ VKM Nr.427 datë 08.06.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”;

Aktet Ligjore/nënligjore për tu analizuar në sektorin e mbetjeve janë:

- ✓ Ligji Nr. 139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”;
- ✓ Ligji Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative dhe territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri”;
- ✓ Ligji Nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
- ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve";
- ✓ Ligji Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”;
- ✓ VKM Nr. 608, datë 17.9.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”;
- ✓ VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”;
- ✓ VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
- ✓ VKM Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”;
- ✓ Vendim nr. 178, Datë 06.03.2012 “Për incenerimin e Mbetjeve”;



- ✓ VKM Nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfillet e mbetjeve”;
- ✓ VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”;
- ✓ VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- ✓ VKM Nr. 175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”;
- ✓ VKM Nr. 967, datë 25.10.2013 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”;
- ✓ VKM Nr. 509, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”;
- ✓ VKM Nr. 504, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”.

Më poshtë ndodhet e renditur një përbledhje paraprake e tërësisë së fushave të kuadrit ligjor, që do të përdoren si bazë dhe referencë në procesin e hartimit të PKS-së. Por duhet sqaruar se gjatë procesit të hartimit të këtij plani do të identifikohen dhe merren në konsideratë edhe të gjitha fushat e tjera me impakt në menaxhimin e mbetjeve. Aktet ligjore apo nënligjore të sektorëve të veçantë, që kanë impakt në procesin planifikues të menaxhimit të mbetjeve, janë të renditura si më poshtë:

1. Kuadri ligjor i mjedisit;
2. Kuadri ligjor i turizmit;
3. Kuadri ligjor i bujqësisë dhe zhvillimit rural;
4. Kuadri ligjor i energjisë;
5. Kuadri ligjor minerar;
6. Kuadri ligjor ushtarak;
7. Kuadri ligjor i transportit;
8. Kuadri ligjor në fushën e të drejtave të pronësisë;
9. Kuadri ligjor per zhvillimin rajonal;
10. Kuadri ligjor i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;
11. Kuadri ligjor për Zhvillim dhe Integrin, etj.

#### 7.4. Përbledhje e Planeve Kombëtare, Rajonale e Vendore

Dokumentat kombëtare të planifikimit përcaktojnë ose orientojnë zhvillimin e ardhshëm, në të gjithë territorin kombëtar ose në një pjesë të tij, kushtet e zhvillimit të strukturave, të përfshira në to dhe vendndodhjen e përbërësve kryesorë të infrastrukturës publike kombëtare.

Hartimi dhe miratimi i tij mbështetet në të gjitha llojet e dokumentave të planifikimit në fuqi në nivel kombëtar, rajonal e vendor (si planet kombëtare, ndërsektoriale dhe sektoriale, ato rajonale, plane vendore të përgjithshme e të detajuara), duke përfshirë edhe ato draft/dokumenta që aktualisht janë në proces hartimi/miratimi, si dhe duke marrë në konsideratë të gjithë historikun e dokumentave planifikuese të miratuara e aplikuara përgjatë viteve, pa përashtuar edhe vendime të ish-KRRTRSH, dhe aktualisht të KKT-së, në fushën e planifikimit të territorit dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta.



## 7.5. Integrimi dhe përputhshmëria

Plani duhet të shërbejë si një strukturë rajonale për zhvillimin e sektorit të menaxhimit të mbetjeve me strukturën e planit kombëtar, ku do të integrohet i gjithë procesi planifikues dhe planet ekzistuese, sektoriale e ndërsektoriale, rajonale e vendore.

Ky proces do të mundësojë zhvillimin strategjik të sektorit të menaxhimit të mbetjeve dhe përputhshmërinë ndërmjet dokumentave të ndryshme të planifikimit të shtrira në të gjithë hapësirën ku ajo shtrihet, pavarësisht objektit të tyre, që mund të jetë *i përgjithshëm* (trajton shumë çështje e sektorë me lidhje komplekse e të përgjithshme ndërmjet tyre sipas territorit e rëndësishë), *plan i detajuar*; dokumenta planifikimi *ndërsektoriale* (trajtonë çështje të dy apo më shumë sektorëve të tillë si/por jo vetëm transporti, furnizimi me ujë, kullimi, e çështje të tjera, me ndërthurje tematike dhe/ose territoriale ndërmjet tyre) apo *sektoriale* (trajtonë çështje të një sektori të caktuar ose fushe të përgjegjësisë së autoriteteve vendore dhe kombëtare).

PKS MMN, si dokument sektorial planifikimi për sektorin e menaxhimit të mbetjeve, do të mbështetet edhe në strategjite sektoriale apo ndërsektoriale të fushave të ndryshme, duke unifikuar politikat kombëtare të planifikimit territorial sektorial dhe mund të përcaktojë rregulla të detyrueshme për t'u respektuar në dokumentat e tjera vendorë, veçanërisht në lidhje me çështjet/zonat e rëndësishë kombëtare ose kur këto përbëjnë rregulla të detyrueshme për mbrojtjen e interesit kombëtar.

## 7.6. Baza e të dhënave

Për të plotësuar dhe mbështetur hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbëtjeve të Ngurta, është i nevojshëm hulumtimi dhe mbledhja e informacionit të të dhënave të caktuara nga arkiva dhe institucionet përkatëse që studiojnë dinamikën për demografinë dhe faktorët social-ekonomike.

Gjithashtu kjo bazë të dhënash, do të plotësohet më tej dhe me informacione të gjeografisë dhe të mjedisit. Në mëyrë që informacioni i mbledhur të analizohet dhe vlerësohet ashtu si duhet, është e nevojshmë ngritura e një grupi të posacëm pune, i cili do të mbledhë gjithë këtë informacion nga institucionet dhe instancat shtetërore (qëndrore dhe vendore) përkatëse. Ai do të analizojë vlefshmërinë, duke arsyetuar për nevojën e përditësimit të tyre në funksion të kritereve, që ky plan për sektorin e menaxhimit të mbetjeve do të vendosë, në mënyrë që produkti final të hartojet duke marrë për bazë parametrat demografike, social-ekonomike, gjeografike dhe mjedisore.

Puna për përgatitjen e këtij plani, nuk presupozon kërkim nga e para të këtyre të dhënave. Thjesht duhet gjykuar e analizuar mbi të dhënat që ekzistojnë dhe më pas aty ku është e nevojshme, të kërkohet asistencia shtesë nga instancat respektive, në mënyrë që zgjidhjet të cilat do të parashtrohen në plan të jenë të iniciuara mbi një kontekst sa më real dhe të azhornuar. Këto të dhëna duhet të analizohen në mëyrë të hollësishme, duke mbledhur nga autoritetet vendore dhe qëndrore informacionet që i shërbejnë këtij qëllimi. Është shumë e rëndësishme që



kjo bazë informacioni të sintetizohet shumë mirë në të gjitha nivelet e planifikimit. Në aspektin demografik, duhet parë se cila është tendenca e lëvizjeve për të ardhmen, në raport edhe me indeksin e rritjes së popullsisë.

Kjo bazë të dhënash është lehtësishët e selektueshme duke qënë se të gjitha njësítë vendore janë në një proces intensiv përgatitjesh për miratimin e dokumentave lokale planifikues duke marrë në konsideratë edhe mbështetjen kryesore që jepin 3 Planet Kombëtare (Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit, Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar dhe Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës). Mbledhja në rrugë institucionale e statistikave do të mbështetet tek autoritetet në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, siç mund të jenë, Ministratë, Institutet mjedisore/gjeodezike, Akademitë Shkencore, Këshillat e Qarqeve, Bashkitë, etj.

Informacion mbi të dhënat mund të merren nga Ministratë dhe nga institucionet e tyre në varësi si:

- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Instituti i Shëndetit Publik;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Kulturës - institucionet në varësi;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Përfaqësues të Njësive Administrative Vendore;
- Agjencitë e Zhvillimit Rajonal;
- Përfaqësues të Qarqeve që preken nga PKS;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Për realizimin e objektivave kryesore të përcaktuara nga Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, është e nevojshme të shfrytëzohen databazat e të dhënavëve ekzistuese që lidhen me gjendjen e territorit, të tillë si, por pa u kufizuar në:

- informacion për topografinë;
- harta gjeologo-inxhinierike;
- harta hidro-gjeologjike;
- makrozonimin dhe mikrozonimin sismik;
- bonitetin e tokave;
- burimet natyrore dhe mjediset pyjore;
- të dhënat mbi fondin e pyjeve, kullotave, sipërfaqeve ujore, rezervateve, minierave, dhe të tjera të kësaj natyre;
- bazë të dhënash mbi zona të mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe historike, dhe të tjera të kësaj natyre;
- të dhëna mbi pozicionimin strategjik në raport me rajonin ku shtrihet vendi, përfshirë identitetin historik, urban dhe ekonomik, si dhe kufijtë territorialë të rajonit të marrë në studim;
- të dhëna të aspektit ekonomik dhe social, përfshirë çështje të punësimit, mundësive apo pengesave për zhvillim ekonomik, aspekteve të konkurrueshmërisë ekonomike apo rajonale, pozicionimit dhe përqendrimit të poleve ekonomike, cilësisë së kapitalit



dhe burimeve njerëzore dhe të pikave të forta apo të dobëta për zhvillimin e ardhshëm ekonomik dhe social;

- të dhëna të aspektit demografik dhe përqendrimin e popullsisë në territor, tendencat e lëvizjeve të popullsisë në vite dhe shpërndarjen e popullsisë;
- të dhëna mbi mënyrën e përdorimit të pronave publike, përfshirë vendndodhjen funksionet dhe marrëdhëniet e pronësisë;
- të dhëna mbi çështjet e rëndësise kombëtare dhe zonat e rëndësise kombëtare dhe kufizimet që rrjedhin nga këto çështje në planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- të dhëna mbi problematikën mjedisore, duke marrë në konsideratë vendndodhjen e elementeve që ndikojnë negativisht mjedisin, vlerat e trashëgimisë kulturore dhe shëndetin e njeriut, si dhe përcaktimin e shkallës së ndikimit negativ të tyre;
- të dhëna mbi problematikën e pronësisë mbi tokën;
- të dhëna mbi përdorimin ekzistues të tokës, bazuar në kategoritë bazë dhe nënkatgoritë e përdorimit të tokës dhe të strukturave në të, rrjetet e infrastrukturave kombëtare;

## 8. BUXHETI

Të gjitha shpenzimet e nevojshme që do të kryhen gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të PKS, MMN do të përballohen nga fondet e ndihmës së huaj që do të sigurohen për këtë qëllim. Në këtë fond buxhetor do të përfshihet edhe shpërblimi për ekspertët e grupeve të punës. Me miratimin nga KKT të nismës për hartimin e dokumentit sektorial të planifikimit për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (PKS), në përputhje të plotë me planin konkret të veprimit dhe zërat përkatës të shpenzimeve të parashikuara në mënyrë të detajuar në fillim të procesit, do të sigurohen dhe alokohen fondet e domosdoshme. Për këtë qëllim në buxhetin vjetor të autoriteteve respektive të planifikimit, do të përfshihen edhe fondet për zbatimin e procesit të hartimit të PKS MMN.

## 9. PËRFUNDIMI I DOKUMENTIT TË NISMËS

Dokumenti i Nismës për hartimin e PKS MMN, vjen si një detyrim ligjor i Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, i cili përcakton përgjegjësitet e ministrive sipas sektorëve të tyre.

Ky material përshkruan nevojën dhe hapat që duhet të ndërmerrin për të mbledhur dhe analizuar bazën e të dhënavës në nivel kombëtar dhe rajonal, si një proces i nevojshëm paraprak për të nisur punën për hartimin e PKS të Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.

I gjithë ky proces do të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues. Planet e miratuara kombëtare dhe sektoriale do të jenë edhe referenca funksionale për të koordinuar strukturën e punës për këtë proces, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe sektorial. Fillimi i punës për hartimin e *Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta* është shumë i rëndësishëm duke marrë në konsideratë zhvillimin që ka patur Shqipëria vitet e fundit përsa i përket planifikimit dhe zhvillimit në sektorë të ndryshëm të saj.

Strategjia e zhvillimit që ky Plan do të implementojë, do të jetë dokument ligjor me hapësira zbatimi për entet apo agjencitë shtetërore sikurse për subjektet private, duke e futur zhvillimin e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në një fazë të re e cila përputhet me një vizion të ri, që ka në



themel zbatimin e pashmangshëm të ligjit. Ky dokument me shtrirje afatgjatë dhe i detyrueshëm në gjithe hapësirën territoriale në sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, do të garantojë përmirësimin e cilësisë së jetës, ruajtjen e vlerave natyrore dhe mjedisin, trashëgiminë në kuptimin më të gjerë të saj dhe do të përfshijë në mënyrë të detyrueshme, qeverisjen në cdo nivel, për ta bërë atë cilësisht të shfrytëzueshme për qytetarin.



卷之三

三